



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KOMISIONI I PAVARUR I KUALIFIKIMIT

Vendim nr. 276/1

“Për korrigjimin e vendimit nr. 276, datë 21.07.2020”

Sot në datë 19.10.2020, trupi gjykues, i përbërë nga:

Brunilda Bektoshi	Kryesuese
Olsi Komici	Anëtar
Lulzim Hamitaj	Relator

Bazuar në ligjin nr. 45/2012, në nenin 112 të Kodit të Procedurave Administrative : “Korrigjimi i gabimeve materiale në aktin administrativ” sipas të cilit përcaktohet se:

- 1. Organi publik, në çdo kohë, kryesisht apo me kërkesë, mund të korrigjojë gabimet e shkrimit, gabimet në përlllogaritje dhe pasaktësi të tjera të dukshme, në një akt administrativ.*
- 2. Organi publik ka të drejtë të kërkojë kthimin e aktit administrativ të shkruar që korrigjohet, si dhe të çdo kopje të njësuar të tij.*

U mblodh për t’u njohur me kërkesën e relatorit të çështjes z. Lulzim Hamitaj, për korrigjimin gabimit material në vendimin e subjektit të rivlerësimit Irena Brahimi, lidhur me mos përshkrimin në dispozitiv pikën 2, siç është vendosur dhe publikuar më datë 21.07.2020.

Në vendimin nr. 276 ,datë 21.07.2020, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, në dispozitiv të vendimit, pas pikës 1, të korrigjohet/zvendësohet përmbajtja e pikës 2, duke kaluar në pikën 3 përmbajtja e pikës 2, (e kështu me radhë të rritet në mënyrë progresive edhe numuri i pikave të tjera), si më poshtë vijon:

Trupa gjyquese, pasi konstatoi se kërkesa e relatorit qëndron dhe korrigjimi i vendimit vjen dukshëm si pasojë e gabimit material, vendosi korrigjimin e vendimit nr.276, datë 21.07.2020, në përputhje me përmbajtjen e publikuar në datën 21.07.2020,

**V E N D O S I:**

1. Në dispozitivin e vendimit nr. 276, datë 21.07.2020, pas pikës 1, të shtohet pika 2, me këtë përmbajtje **“Transferimin e çështjes civile - me palë ndërgjyqëse: paditës A. Ç, e të paditur: Zyra Përmbartimore “\*\*\*\*” sh.p.k., dhe me objekt: “Kundërshtim i veprimeve përmbartimore”, - të shqyrtuar në Gjykatën e Apelit Gjirokastër dhe të përfunduar me vendimin nr. \*\*\*, datë 12.5.2015, pranë organit kompetent për**

**inspektimin e shkaqeve që mund të përbëjnë shkelje disiplinore, sipas pikës 4, të nenit 59, të ligjit nr. 84/2016”.**

2. Përmbajtja e pikave të tjera të dispozitivit nuk ndryshon, veç numrit rendor.
3. Të njoftojë subjektin e rivlerësimit, Komisionerin Publik dhe Vëzhguesin Ndërkombëtar për këtë korrigjim.
4. Të kërkohet nga të mësipërmit kthimi i vendimit të shkruar që të korrigjohet, si dhe të çdo kopje të njesuar të tij.
5. Vendimi i korrigjuar të publikohet në faqen zyrtare të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit.
6. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

### **ANËTARËT E TRUPIT GJYKUES**

**Brunilda Bekteshi    Kryesuese**

**Olsi Komici            Anëtar**

**Lulzim Hamitaj      Relator**

Sekretare gjyqësore

Anisa Duka